REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 51, datë 24 .12. 2012

PËR
"NJË NDRYSHIM (SHTESË) NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR. 3, DATË 05.02.2007 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS"

Në mbështetje të nenit 11, pika 3, shkronja "d", nenit 16 dhe nenit 32, shkronja "f", të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar); nenit 128 i ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); neneve 5, 9/9, 14 dhe 33, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) dhe ligjit nr.8934, 05.09.2002 për "Mbrojtjen e Mjedisit" (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Në pikën 1 (Taksat Vendore), të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.02.2003 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", shkronja "g" ("Taksa e përkohshme e gjelbërt" 2007-2010), ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

   "g" "*Taksa e përkohshme për ndikimin e antenave të telefonisë së lëvizshme" 2013-2015*

   "Taksa e përkohshme për ndikimin e antenave të telefonisë së lëvizshme" aplikohet për të gjithë subjektet që vendosin antena të telefonisë së lëvizshme (mobile) mbi tarracat e pallateve apo godinave të ndryshme brenda territorit të qytetit të Tiranës. Niveli i kësaj takse është 2.000.000 Lekë/antenë/vit.

   Mënyra e pagesës:

   Taksa e përkohshme për ndikimin e antenave të telefonisë së lëvizshme", llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Detyrimi lind nga momenti që vendosja e antenës konstatohet në terren.
   Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 15 shkurt. Kësti i dytë jo më vonë se data 15 maj, kësti i tretë jo më vonë se data 15 gusht dhe kësti i fundit jo më vonë se data 15 nëntor e vitit korrent fiskal.

Për çdo antenë të vendosur rishtaz, afati i pagesës së taksës do të jetë 30 ditë pas lindjes së detyrimit".

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI